VENDIM
Nr. 589, datë 1.7.2015

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT",
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 2, 15, pika 3, dhe 18, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e personave të shpallur sipas rezolutës së Këshillit të Sigurimit (lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar, pas shkronjës "D", shtohet shkronja "DH" me përmbajtjen, si më poshtë vijon:

"DH. Lista e individëve anëtarë ose bashkë-punëtorë të organizatave terroriste.

NIKOLAOS MAZIOTIS - shtetas grek;

CHRISTODOULOS XIROS - shtetas grek.".

2. Ngarkohen autoritetet përgjegjëse, të përcaktuara në nenin 7, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama